



REPUBLIKA E SHQIPËRISË GJYKATA KUSHTETUESE

Njoftim për lëvizje paralele dhe për pranimin në shërbimin civil në administratën e Gjykatës Kushtetuese - Specialist i Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, bazuar në Ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, Gjykata Kushtetuese shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

Specialiste i/e nivelit të lartë për marrëdhëniet me publikun dhe ato protokollare në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe Jashtë -kategoria III-b

Pozicioni më sipër, i afrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën lëvizjes paralele brenda institucionit të Gjykatës Kushtetuese! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

AFATI I PARAQITJES SE DOKUMENTAVE

Afati për dorëzimin e dokumentave fillon me datën **19.02.2018** dhe përfundon me datë **06.03.2018**.

Rezultatet e verifikimit paraprak

Pas përfundimit të këtij afati, njesia perkatese do të bëjë verifikimin paraprak të kandidateve që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të vecanta dhe brenda 10 ditëve do të shpallë rezultatet e këtij vlerësimi paraprak, në bazë të dokumentacioneve të paraqitura. Listen e kandidateve që plotësojnë këto kritere si dhe datën dhe orën kur do të zhvillohet intervista, njekohesisht do të njoftohen kandidatët e skualifikuar. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankese brenda tre ditëve prane njesisë perkatese. Rezultatet do të njoftohen në faqen e webit të Gjykatës Kushtetuese dhe në kendin e njoftimeve të kësaj gjykate.

Pershkrimi i detyrave qe kryen specialisti/ja në këtë vënd pune jane:

- 1) Harton dhe propozon strategji konkrete për përmirësimin e marrëdhënieve të Gjykatës me publikun dhe me median;
- 2) Përpunon shtypin e ardhur ose atë elektronik, nxjerr prej tij probleme që lidhen me drejtësinë, me veprimtarinë gjyqësore në përgjithësi dhe posaçërisht me atë të kësaj Gjykate, duke ia bërë ato të njohura Kryetarit dhe anëtarëve të Gjykatës nëpërmjet një komunikate të përditshme me shkrim;
- 3) Kujdeset për mbajtjen dhe përditësimin e dosjeve me informacionet përkatëse që lidhen me Gjykatën Kushtetuese të nxjerra nga përpunimi i përditshëm i shtypit të shkruar ose atij elektronik;
- 4) Përgatit njoftime me karakter informues mbi veprimtari të ndryshme të Gjykatës (seminare, mbledhje pune, takime pune me delegacione të gjykatave të tjera apo delegacione e përfaqësi të organizmave ndërkombëtarë), të cilat publikohen në faqen e internetit të Gjykatës;
- 5) Përgatit njoftime me karakter informues mbi veprimtari të ndryshme të Gjykatës (seminare, mbledhje pune, takime pune me delegacione të gjykatave të tjera apo delegacione e përfaqësi të organizmave ndërkombëtarë), drejtuar medias dhe i dërgon ato për botim në shtypin e shkruar/elektronik ose për transmetim;
- 6) Kur çmohet, nën kujdesin e gjyqtarit relator të çështjes, përgatit njoftime për publikun dhe median mbi vendimmarrjen gjyqësore të Gjykatës;
- 7) Perditeson faqen elektronike te institucionit me te gjitha informacionet zyrtare, buletinet e ndryshme javore, mujore etj me qellim transparencen ndaj publikut.
- 8) Komunikon informacionet me interes ndaj medias dhe publikut ne perputhje me dispozitat ligjore ne menyre transparente korrekte dhe te besueshme.
- 9) përgatit konferencat për shtyp të Kryetarit të Gjykatës;
- 10) Asiston në takime e mbledhje pune që zhvillon Kryetari, merr pjesë në gjykime dhe në shpallje të vendimeve;
- 11) Ndihmon në mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit vjetor të kërkesave dhe përgjigjeve, në kuadër të programit të transparencës së institucionit;
- 12) Trajton kërkesat e qytetarëve që nuk janë në kompetencë të Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit.

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kritere të veçanta për specialistin/en i/e nivelit të lartë për marrëdhëniet me publikun dhe ato protokollare :

- a) Te zoteroje nje diplome Master i shkencave ose Master profesional në degën Gazetari dhe Komunikim. Perben avantazh pasja e nje diplome ne shkencat juridike;
- b) Te kete pervojë pune mbi 5 vite ne nje institucion te nivelit te larte te administrates shtetërore;
- c) Te kete note mesatare mbi 8;
- d) Të zotërojnë një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze, ose nje prej gjuhëve të BE-së;
- e) Të ketë aftësi shumë të mira në komunikim ne gjuhen e huaj qe ai/ajo zotëron;
- f) Të zotërojnë metodat e reja të informacionit dhe të ketë aftësi të shumë të mira të njohjes e përdorimit të PC në programet baze të tij.

PER PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, do te ndiqet procedura për konkurrim sipas dispozitave perkatese per pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Te gjithë kandidatet duhet te plotesojne kerkesat e vecanta dhe ato te pergjithshme te Nenit 21te Ligjit Nr 152/2013 Per Nenpunesit Civil. .

DOKUMENTACIONI DHE MËNYRA E DORËZIMIT

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë pranë Drejtorise se Ekonomike dhe Burimeve Njerzore , dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip.
- b) Nje Kërkesë për aplikim.
- c) Fotokopje e diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor).
- d) Fotokopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vertetojnë eksperiencën në punë).
- e) Fotokopje e letërnjoftimit (ID).
- f) Vertetimin e gjendjes shëndetësore.

- g) Vertetimin e gjëndjes gjyqësore/formulari i plotësuar për verifikim.
- h) Vlerësimet e fundit nga eprori direkt.
- i) Vërtetimin nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE.

Kandidatët për pranimin në shërbimin civil do të vlerësohen me shkrim nga Komiteti i Pranimi të Përhershëm pranë Gjykatës Kushtetuese. Mënyra e vlerësimit dhe procedurat që ndiqen për kandidatet është e përcaktuar në dispozitat përkatëse të ligjit si dhe në udhëzimet përkatëse të DAP.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës.
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme.
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Kandidati duhet të zotërojë njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike; aftësi për të integruar informacionin me nevojat e Institucionit, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale.

Fusha e njohurive për kandidatet që do të testohen do të jenë:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Ligji për organizimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Rregullorja e brendshme; Ligji për statusin e nepunësve civilë; Ligji për rregullat e etikës në administratën publike; Ligji për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative; Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale; legjislacioni në fuqi për sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë me aktet nënligjore që rregullojnë këto veprimtari.

Procesi i vlerësimit do të bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nëpërmjet një konkurrimi, që përfshin një testim të shkruar, dhe një testim me gojë.

Testimi i kandidateve do të zhvillohet në Gjykatën Kushtetuese me datën 20.03.2018.

Intervista e strukturuar do të zhvillohet me datën 21.03.2018.

Lista e fituesve do të shpallet në datën 22.03.2018.

Lista perfundimtare do të shpallet me datën 30.03.2018. Njoftimi do të bëhet: në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Gjykes Kushtetuese dhe në kendin e informimit të publiku te institucionit.

Paraqitja e kërkeses dhe dokumentave do të bëhet pranë Kryetarit të Gjykes Kushtetuese ose Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerezore, brenda datës **06.03.2018**.

Per me shume informacion per Gjykatën Kushtetuese dhe veprimtarinë e saj mund të vizitoni edhe faqen tonë në internet: www.gjk.gov.al

Per sqarime të metejshme mund të kontaktoni me numrin telefonik 04 2243698, ose në adresën: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, nr.26, Tiranë.

GJYKATA KUSHTETUESE

Tiranë, më 16.02.2018.